



STARTTS - Shërbimi për shërimin dhe rihabilitimin e shpëtuesve nga tortura dhe trauma.

Albanian Shqip

Kush Jemi Ne (Who We Are)

Në kuadrin e integritimit humanitar dhe si bashkë-nënshkruese e Konventës së Kombeve të Bashkuara për Statusin e Refugjatëve, Australia ka strehuar refugjatë me përkatësi të ndryshme kombësie, kulture, fetare dhe gjuhë, që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore.

Programi i kohëve të fundit përfshinë deri në 10,000 njerëz ç'do vit, 40% e të cilëve vendosen në NSW (Velsi i Ri Jugor i Australisë) ku mbi 60% prej tyre llogariten të jenë viktimë të torturës.

Konsenkuencat e Torturës fizike mund të përfshijnë dhimbje kronike, eshtra të thyera, dëmtime të syve, dhëmbëve, veshëve, ato të organeve gjentiale, të rektumit, të organeve të riprodhimit, ç'rregullime kardio-pulmonare, lëndime të trurit dhe sëmundje të tjera të rezultuara si pasojë e traumës apo torturave.

Mirëpo, efektet psikologjike janë shpesh më të tmerrshme dhe më shkatërruese. Ato mund të jenë depresioni, zemërim drastik, pagjumësi (veçanërisht gjumë jo të rehatshëm, i shoqëruar me ëndërra trishtuese), dëmtime të trurit, sensi i vetë-vrasjes, humbje të konfidencës në vehte, si dhe probleme të kujtesës, mendime intrusive dhe përsëritje imagjinare të torturave të përjetuara, vështirësi në marrëdhënie sociale, si dhe të konflikteve familjare.

Ndërkohë, refugjatët mund të hasin vështirësi me problemet e emigracionit, dhe rreziku i deportimit e komplikon problemin akoma më tej, ndërkohë duke mos harruar dhe faktin e vështirësive që mund të haset në aspektin e gjuhës, dhe normave të ndryshme sociale dhe atij të sistemit politiko-social.

Asistenca e specializuar, dhe intervenimi i sa më i hershëm janë të rëndësishëm së veçantë, në parandalimin e efekteve të eskpëriencave të hidhura të lartë-përmendura në asistimin e viktimave të torturës dhe traumës në normalizimin e jetës së tyre.

Që nga themelimi i saj, STARTTS ka qenë kryesuese, në ofrimin e asistencës së nevojshme dhe në përgjigje të nevojave të refugjatëve, në aspektet e lartë-përmendura, për në shtetin e NSW-sit.

ra për projekte specifike.

Historiku Ynë (Our History)

Gjatë viteve të 1980-ve, në mesin e komuniteteve të refugjatëve si dhe të disave nga personeli i shëndetsisë, sa vinte akoma më shumë thellohej ideja se vetëm sistemi shëndetsorë ishte i pamundur t'u bënte ballë nevojave të refugjatëve të ish-torturuar, apo të viktimave mbijetuese të traumës. Gërshetimi i ideve të dy grupeve të lartë-përmendura, rezultuan në krijimin e organizatës STARTTS, gjë e cila u mundësua në fundin e vitit 1988.

Që nga vitet e para të themelimit STARTTS ka patur një rritje të konsiderueshme, në ushtrimin e aktiviteteve të sajë, në përgjigje të nevojave të klientelës.

STARTTS punëson një personel multi-disiplinorë si dhe multi-kulturorë, duke rrjedhur nga kultura apo popuj të ndryshëm, përfshirë këtu dhe faktin e shërbimeve në gjuhë të ndryshme, gjë e cila lehtëson shumë komunikimin dhe përmbushjen e nevojave të klientelës,

Shërbimi udhëheqet nga një komitet drejtues, i caktuar nga Ministri i Shëndetsisë, i shtetit të NSW (New South Wales), i cili përfshinë përfaqësues nga Organizata Për të Drejtat e Njeriut, profesionista në lëminë e shëndetsisë, si psikiatëra dhe personel me pozita të ndryshme në komunitet.

Burimi kryesorë i sponsorizimit të organizatës STARTTS është Departamenti i Shëndetsisë së NSW, duke mos harruar edhe fondet nga Departamenti Federativ për Shëndetsinë, si dhe Shërbimet Familiare e burime të tjera për projekte specifike.

Misioni Ynë (Our Mission)

Misioni i ynë është të zhvillojmë dhe implementojmë mënyrat e proceseve shëruese të viktimave të torturës, apo refugjatëve të traumatizuar, si dhe të ndihmojmë individ dhe organizata që punojnë në këtë fushë pregaditjen e tyre në dhënien e shërbimive në mënyrë efektive duke konsideruar kulturën dhe zakonet e klientëve.

Shërbimet Tona (Our Services)

Si pasojë e mardhënieve tona me klientelën tonë, kemi zhvilluar një shërbim të mirëfilltë për të ndihmuar viktimat e torturës dhe traumës.

Shërbimet tona janë për pjesën e popullsisë së NSW-it (Velsit të Ri Jugor) që kanë përjetuar trauma dhe tortura në konteksts të organizuar nga organizatat shtetërore dhe tani kanë emigruar në NSW.

Disa nga shërbimet më kryesore janë:

- *këshillime dhe terapi, duke marrur në konsiderim kulturën dhe zakonet e individëve, të familjeve dhe grupeve;
- *fizoterapi, hidroterapi dhe terapi të ndryshme për kontrollimin e dhimbjeve trupore;
- *punë me grupe të ndryshme;
- *aktivitetete për rininë, siç janë kampinget dhe ekskurzionet;
- *ndihmë me gjetjen e punës;
- *njoftim me organizata dhe shërbime tjera të nevojshme;
- *projekte për zhvillimin e komuniteteve;
- *lobi për çështjet e refugjatëve; dhe
- *programe edukative.

STARTTS gjithmonë ka punësuar specialistë me prejardhje të ndryshme kulturore. Personali i STARTTS-it përfshinë një numër të madh të gjuhëve të huaja, gjë e cila lehtëson shumë komunikim dhe përmbushjen e nevojave të klientelës.

STARTTS poashtu ka në disponim përkthyes profesional në shumë gjuhë.

Nëse ju nevoiten më shumë informata rreth shërbimit tonë,
mundeni të na kontaktoni në:

STARTTS

**152-168 The Horsley Drive,
Carramar NSW 2163
Australia**

Telefon: (02) 9794 1900

Faks: (02) 9794 1910

Zyra e jonë është e hapur prej orës 8:30 deri në 5:00 pas dite, prej
të Hënës deri në ditën e Premte.

Shërbimet tona janë falas dhe rrespektojmë plotësisht ligjet për
mbrojtjen e informatave.